



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:277387

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392195

C – IV. – 15 - 0106

Paditësi :

E T nga fshati S i Komunës së Podujevës e me numër personal

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë” Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i 3 (tre) pagave të pa paguara.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës dëgjimore, me dt.29.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET poshtë si e pa pranueshme padia e paditësit, E T nga fshati S i Komunës së Podujevës për kompensimin e 3 (tri) pagave të pa paguara nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh, ”Industria e Mishit dhe Frigorifer, Kosovë” me seli në Fushë Kosovë (në likuidim).

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Me dt.05.02.2015, paditësi, E T nga fshati Si Komunës së Podujevës, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), ka parashtruar kërkesë kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe lidhur me Vendimin e

kontestuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Industria e Mishit dhe Frigorifer, Kosovë" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim) e që ka të bëjë me kërkesën për kompensimin e 3 (tri) pagave të pa paguara.

Pala paditëse parashtresën e saj të drejtuar në DhPGJSK, e ka titulluar si "kërkesë", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në këtë ankesë ka theksuar se nga ana e Bordit të ish AKM-së, me anë të kontratës së plotëfuqishme me dt.15. Dhjetor 2006, është shitur gjegjësisht është privatizuar NSh, "Industria e Mishit dhe Frigorifer në Kosovë" me seli në Fushë Kosovë prej 11.04.81 ha, se në këtë ndërmarrje ka qenë i punësuar si punëtor i kompresorit në sallën e kompresorëve prej viti 1986 e deri në vitin 2006 kur është privatizuar kompania në fjalë, se gjatë falimentimit të saj, "Industria e Mishit dhe Frigorifer" me seli në Fushë Kosovë, i ka mbetur pa paguar 3 (tri) paga të punëtorëve të cilët kanë kontribuar në këtë Industri e më gjerësisht si në këtë kërkesë/padi.

Paditësi, si provë kërkesës/padisë së tij, ia ka bashkangjitur në kopje të tyre : Njoftimin e dt.15 Dhjetor 2006 të AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës tek e paditura, Shkresën e AKM-së së dt.13. Dhjetor 2006 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Industria e Mishit dhe Frigorifer, Kosovë" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim), dhe kopjen e ID-së së tij por jo edhe kopjen e Vendimit të kontestuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) "Industria e Mishit dhe Frigorifer" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim).

Me dt.15.11.2023, kjo gjykatë me aktvendimin e saj, C – IV. – 15 – 0106 të dt.15.11.2023, ka urdhëruar paditësin, E T nga fshati S i Komunës së Podujevës që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij, t'a plotësoj padinë (kërkesën) e tij të dt.05 Shkurt 2015, në atë mënyrë që t'a precizoj lartësinë në vlerë monetare të kërkesës si dhe për periudhën kohore për të cilën i kërkon 3 (tri) pagat mujore nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Industria e Mishit dhe Frigorifer, Kosovë " me seli në Fushë Kosovë (në likuidim) si dhe kësaj padie (kërkesë), t'ia bashkangjes, egzemplarin e Vendimit të kontestuar të Autoritetit të Likuidimit (AL) e që ka të bëjë me 3 pagat e pa paguara nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Industria e Mishit dhe Frigorifer Kosovë " me seli në Fushë Kosovë (në likuidim) si dhe provat tjera në mbështetje të kërkesës e me pasojën ligjore se nëse paditësi, nuk vepron brenda afatit të dhënë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata në bazë të nenit 36 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), padinë e paditësit, do t'ia hedh poshtë si të pa pranueshme ose të njëjtën padi/ kërkesë, do t'ia refuzoj si të papabuar.

Pala paditëse, aktvendimin e kësaj gjykate C – IV. – 15 – 0106 të dt.15.11.2023, e ka pranuar me dt.20.11.2023 dhe se gjykata nuk ka prova se pala paditëse, ka vepruar brenda afatit të dhënë sipas këtij aktvendimi por edhe deri më tani nuk e ka bërë plotësimin e padisë së tij.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit, E T nga fshati Si Komunës së Podujevës, hedhet poshtë si e papranueshme. Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Në bazë të nenit 33 dhe nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme, bëhet fjalë për rregullimin e parashtresave përkatësisht të kërkesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme dhe se në nenin 35 par.2 të këtij ligji parashihet se çka duhet të përmbaj një kërkesë/padi, si në rastin konkret.

Në nenin 36 paragrafi 2, pika 2.5 dhe 2.6 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, parashihet se: *''Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: ... Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; ... është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa ...''* kurse në nenin 74 par.2 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, që flet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim, aty përcaktohet se: *''Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund t'a kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. ... Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi''*.

Po ashtu neni 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, që kanë të bëjnë me hudhjen poshtë si jo të plotë të një padie në procedurën kontestimore sepse e njëjta padi, ka mangësi sa i përket të dhënave, duhet t'i kishte për të vepruar sipas saj, e dispozita këto të cilat në rastin konkret, duhet të zbatohen përshtatshmërisht sipas 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme e në nenin 99 par.2 të LPK-së, parashihet se: *''Parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre''* derisa në nenin 102 par 3 të LPK-së, parashihet se: *'' ... Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë''*. Duke pasur për bazë se në frymën e nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla e me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet t'a dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ndërsa në nenin 253 par. 4 dhe par.5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se: *''Padia duhet të përmbajë: a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore; b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën; c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla; d) vlerën e kontestit; e) bazën juridike dhe f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji)''*. Në rastin konkret, meqë kërkesa/ padia e paditësit, ka qenë jo e plotë, të njëjtit, kjo gjykatë, me aktvendimin e saj, C – IV. – 15 – 0106 të dt.15.11.2023, në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, ia ka dhënë mundësinë për t'a plotësuar kushtin e pranueshmërisë së kërkesës së tij në atë mënyrë që të njëjtin e ka urdhëruar,

që në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, kërkesës së tij, t'ia bashkangjes, egzemplarin e Vendimit të kontestuar të Autoritetit të Likuidimit (AL) e që ka të bëjë me 3 pagat e pa papaguara nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), *''Industria e Mishit dhe Frigorifer Kosovë''* me seli në Fushë Kosovë (në likuidim) si dhe provat tjera në mbështetje të

kërkesës mirëpo deri më tani, pala paditëse, nuk ka vepruar sipas aktvendimit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 - 0106 të dt.15.11.2023, e që kërkeës së tij, t'ia bashkangjes, egzemplarin e Vendimit të kontestuar të Autoritetit të Likuidimit (AL) si dhe prova tjera në mbështetje të kërkesës së tij dhe se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, padinë e paditësit, E T nga fshati S i Komunës së Podujevës, kjo gjykatë e hodhi poshtë si të pa pranueshme.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36, dhe nenit 74 të Ligjit, nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) .

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

2022:277387, 29.02.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).